



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.995, datë 09.10.2009**

**Për**  
**caktimin e kodit të shkurtër (0) 801 711 sipërmarrësit**  
**“Albania Satellite Communication” sh.p.k**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 09.10.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, e amenduar me VKD Nr. 746 dt. 17.07.09, bazuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Albanian Satellite Communication” shpk për caktimin e kodit të shkurtër për ofrimin e shërbimit “Thirrje me Kartë”.

**BAZA LIGJORE :**

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – pika j) dhe nenet 80 deri 90;
- “Rregullorja për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me VKD Nr. 932 datë 11.08.2009.
- “Rregullorja e Brendshme e AKEP” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I :**

1. Të miratoje kërkesën e sipërmarrësit “Albanian Satellite Communication” shpk për caktimin e kodit të shkurtër për ofrimin e shërbimit “Thirrje me Kartë”.
2. Në kategorinë e shërbimit “Thirrje me Kartë” (Calling Card) të Planit Kombëtar të Numeracionit, sipërmarrësit “Albania Satellite Communication” shpk i caktohet për përdorim të përhershëm kodi i shkurtër:

**(0) 801 711**

Ku:

- “0” -prefiksi kombëtar.
- “801” -identifikon Kodin e Aksesit të kategorisë së shërbimit “Thirrje me Kartë”, i harmonizuar në nivel kombëtar.
- “711” -Numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin.

3. Ngarkohen Drejtoria e Licensimit për njoftimin e sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera të AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**